“Master Profesional” në Kontabilitet – Financë

Emertimi akademik i studimit	**Diplomë “Master Profesional” në Kontabilitet – Financë**
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	AKREDITUAR me VENDIM Nr.26, datë 07.02.2025
Cikli i studimit	Cikli i dytë (Master Profesional)
Emri dhe statusi i insitucionit	Universiteti “Eqrem Çabej”, Fakulteti Ekonomik, Institucion Publik, Akredituar
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	2 (dy) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	**1.** Kanë të drejtë të aplikojnë për t’u regjistruar në programin e studimeve të ciklit të dytë **“Master Profesional”** në Kontabilitet Financë, individët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të pare dhe kanë fituar një diplomë universitare “Bachelor” në fushën e ekonomisë ose fusha të tjera të përafërta. **2.** Kriteret e pranimit për këtë program studimi janë si më poshtë vijon: **a. Kriteri** i **meritës.** Nota mesatare e ponderuar e studimeve të ciklit të parë bachelor **b. Kriteri i rëndësisë.** Koeficienti i profilit të studimeve Bachelor sa i takon përputhshmërisë me fushën dhe programin e studimit te Njësisë Bazë të Kontabilitet Financës si më poshtë: • Kandidatët e diplomuar në Kontabilitet Financë në Universitetin e Gjirokastrës, në të njëjtin profil/program studimi që është bërë aplikimi, **koeficenti 1.0** • Kandidatët e diplomuar në Kontabilitet Financë jashtë Universitetit të Gjirokastrës, në të njëjtin profil/program studimi që

	është bërë aplikimi, **koeficenti 0.9.** • Kandidatet e diplomuar në ekonomi në Universitetit të Gjirokastrës, jashtë profileve të studimit që është bërë aplikimi, **koeficienti 0.85.** • Kandidatët e diplomuar në ekonomi jashtë Universitetit të Gjirokastrës, , jashtë profileve të studimit që është bërë aplikimi, **koeficienti 0.8.** • Kandidatet e diplomuar jo në ekonomi , jashtë profileve të studimit që është bërë aplikimi, **koeficienti 0.7.** **c.** Kuotat e paracaktuara nga **Njësia Bazë** e **Kontabilitet Financës.** **3.** Përzgjedhja e kandidatëve fitues në programin e studimit **"Master Profesional" në Kontabilitet Financë** do të jetë rezultat i produktit: **Notë mesatare e ponderuar në programin e studimit bachelor** * **koeficent** (sipas profilit dhe programit të studimit që aplikohet); duke gjeneruar kësisoj një listë vlerësimi e cila shpall si fitues të renditurit sipas kësaj listë **brenda kuotave** të paracaktuara nga NJB për këtë program studimi. **4.** Studentët që kanë përfunduar studimet dhe janë diplomuar jashtë vendit në të njëjtin program ose programe të përafërta studimi, në rast pranimi duhet të kryejnë njësimin e diplomës pranë QSHA. **5.** Kandidati duhet të ketë të mbrojtur një prej 5 gjuhët e huaja në përputhje me nivelet e parashikuara në Udhëzimin Nr. 10, datë 16.06.2023 (për një ndryshim në Udhëzimin Nr.52, datë 3.12.2015) , për "Përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e Arsimit të lartë, të ndryshuar". (Niveli B1)

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Objektivi kryesor i këtij programi studimi është formimi i ekspertëve dhe specialistëve të mirëfilltë, me cilësi dhe shprehi të larta teknike dhe profesionale në fushën e financave dhe kontabilitetit. Programi Master Profesional në Kontabilitet-Financë është me natyrë aplikative dhe ofron formim kryesisht praktik, për arritjen e objektivave profesionale në fushat e mësipërme, me synimin e pajisjes së studentit me aftësi dhe njohuri të thelluara të kuadrit zbatues në fushën e financës, kontabilitetit dhe auditimit, për të garantuar një karrierë të suksesshme profesionale. Në fokusin e tij të plotë, ky program studimi gërsheton njohuri teorike dhe praktike për të inkurajuar tek studenti mendimin kritik dhe kreativ, si dhe t'i ekspozojë ata drejt çështjeve bashkëkohore dhe kyçe në fushën e financave dhe kontabilitetit, nëpërmjet një modeli mësimi të mbështetur fuqishëm nga praktikat më të mira.

Programi Master Profesional në Kontabilitet–Financë i profilizon studentët në fusha të ndryshme si:

a. Drejtimi financiar i bizneseve dhe vendimmarrja financiare;
b. Hartimi, përdorimi, analiza dhe interpretimi i pasqyrave financiare sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar;
c. Planifikimi dhe administrimi i tatimeve sipas legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar;
d. Matja, vlerësimi, analiza dhe menaxhimi i riskut;
e. Vlerësimi i investimeve dhe përzgjedhja e tyre;
f. Dizenjimi, përdorimi dhe auditimi i sistemeve të kontabilitetit;
g. Planifikimi, organizimi dhe menaxhimi i procedurave të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.

Ky program studimi përgatit specialistë me cilësi dhe shprehi të larta teknike dhe profesionale drejt një karriere të suksesshme, në përputhje me modelet dhe vizionet bashkëkohore të strukturave institucionale publike dhe private, në kontekstin e globalizimit dhe integrimit europian.

VEPRIMTARITË FORMUESE

1. **Lëndë të formimit të përgjithshëm** (Ekonomiksi Menaxherial, Drejtimi i Shpërblimit.) **Kredite gjithsej: - 12 ECTS**
2. **Lëndë të formimit karakterizues** (Tregjet dhe Institucionet Financiare, Analiza e Pasqyrave Financiare, Drejtimi Financiar Ndërkombëtar, Teknika Bankare, Auditim, Drejtimi Financiar i Avancuar, Kontabiliteti i Avancuar, Drejtim Portofoli) **Kredite gjithsej: - 48 ECTS**
3. **Lëndë ndërdisiplinore / integruese** (Sistemi Tatimor Tregëtar, Menaxhim Projektesh, Organizimi i Sistemeve të Kontabilitetit dhe Kontrollit, Analizë Investimesh, Lëndë me zgjedhje.) **Kredite gjithsej: - 33 ECTS**
4. **Lëndë të formimit plotësues** (Praktika Profesionale) **Kredite gjithsej: - 12 ECTS**
5. **Provim Formimi** (Mikroteza) **Kredite gjithsej: - 15 ECTS**

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm : 1- 4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7- 8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	**PIKËT**
4 (katër)	1 - 44 pikë
5 (pesë)	45 - 54 pikë
6 (gjashtë)	55 - 64 pikë
7 (shtatë)	65 - 74 pikë
8 (tetë)	75 - 84 pikë
9 (nëntë)	85 - 94 pikë
10 (dhjetë)	95 - 100 pikë

MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Pas përfundimit me sukses të programit Master Profesional në Kontabilitet-Financë, studentëve u hapen disa rrugë për zhvillim të mëtejshëm akademik dhe profesional. Disa nga mundësitë kryesore janë:

1. Ndjekja e një Masteri Shkencor (MSc) në fusha të ngjashme si Financë, Menaxhim Financiar, Kontabilitet, Ekonomi ose Auditim, brenda dhe jashtë vendit. Ky cikël studimi u lejon studentëve të thellojnë më tej njohuritë e tyre teorike dhe kërkimore.

2. Specializime të avancuara dhe trajnime profesionale, siç janë certifikimet ndërkombëtare: (ACCA, CPA,CIE). Këto certifikime janë të kërkuara në tregun global dhe shtojnë konkurrencën e individit në karrierë.

3. Studime doktorale (PhD) për ata që dëshirojnë të ndjekin një rrugë akademike dhe kërkimore në ekonomi, financë apo kontabilitet (me kushtet përkatëse të pranimit në programet përkatëse)

4. Programe të shkurtuara pasuniversitare (postgraduate diplomas) në fusha të ngushta të sektorit financiar ose të teknologjisë financiare (FinTech), të cilat ofrohen gjithnjë e më shumë nga universitete apo platforma ndërkombëtare.

Ky program studimi ofron një bazë të fortë teorike dhe praktike që shërben si trampolinë për të gjitha këto drejtime zhvillimi, sipas synimeve dhe interesave të secilit student.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Programi Master Profesional në Kontabilitet-Financë synon të përgatisë specialistë të aftë për të përmbushur kërkesat e tregut të punës, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.

Ky program i ofron studentëve njohuri të avancuara praktike dhe teknike në fushat kryesore të kontabilitetit dhe financës, duke i aftësuar ata për të marrë role të rëndësishme në institucione dhe biznese të ndryshme.

Pas përfundimit të këtij programi, të diplomuarit kanë mundësi të punësohen në;

1. Njësi financiare e kontabël të kompanive private e publike.
2. Zyra kontabiliteti dhe auditimi.
3. Institucione financiare (banka, fonde investimi, sigurime).
4. Administratën tatimore dhe institucionet shtetërore.
5. Organizata ndërkombëtare dhe projekte zhvillimi.

Gjithashtu ata mund te ndjekin trajnime te metejshme dhe certifikime profesionale si:

Kontabilist i Miratuar (KM)

Auditues i Brendshëm ose i Jashtëm

Ekspert tatimor

Ekspert Kontabël i Autorizuar (EKA)

Certifikime Ndërkombëtare (ACCA, CPA, CIA) etj

Sistemi i njohurive që ofrohet nga programi i studimit të Ciklit të Dytë “Master Profesional” në Kontabilitet Financë dhe kompetencat që përfitojnë studentët nëpërmjet tij u mundësojnë atyre ndjekjen e një karriere të suksesshme. Pas përfundimit të këtij programi studimi, në sajë të njohurive të marra, studenti ka akumuluar gjithë aftësitë e nevojshme si ekspert në financë, kontabilitet dhe auditim, në një nivel të lartë njohurish shkencore teorike dhe praktike.

DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT (*plani mësimor*)

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i parë				
1.	Ekonomiksi Menaxherial	**6**	**60**	**I**
2.	Drejtimi i Shpërblimit	**6**	**60**	**I**
3.	Tregjet dhe Institucionet Financiare	**6**	**60**	**I**
4.	Analiza e Pasqyrave Financiare,	**6**	**60**	**I**
5.	Drejtimi Financiar Ndërkombëtar	**6**	**60**	**I**
6.	Teknika Bankare	**6**	**60**	**II**
7.	Auditim	**6**	**60**	**II**
8.	Drejtimi Financiar i Avancuar	**6**	**60**	**II**
9.	Sistemi Tatimor Trgëtar	**6**	**60**	**II**
10.	Menaxhim Projektesh	**6**	**60**	**II**
Gjithësej viti i parë		**60 ECTS**	**600**	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i dytë				
1.	Organizimi i Sisteve të Kontabilitetit dhe Kontrollit	**7**	**75**	**I**
2.	Kontabiliteti i Avancuar	**6**	**60**	**I**
3.	Analizë Investimesh	**7**	**60**	**1**
4.	Drejtim Portofoli	**6**	**60**	**I**
5.	**Lëndë me zgjedhje**	**7**	**60**	**I**
	Kontabilitet Kosto Drejtimi i Avancuar			
	Vlerësim Pasurie			
	Sistemet e informacionit dhe Menaxhimit			
6.	**Praktika Profesionale**	**12**	**300**	**II**
7.	**Detyrimi Përmbyllës**	**15**	**50**	
Gjithësej viti i dytë		**60 ECTS**	**650**	
Gjithësej viti i parë dhe viti i dytë (I+II)		**120 ECTS**	**1250**	